

V E N D I M
Nr. 515, datë 24.10.2002

**PËR SHPALLJEN PASURI KULTURORE MONUMENT KULTURE ME KARAKTER
KOMPLEKS, DHE VËNIEN NË MBROJTJE TË SHTETIT TË ZONËS ARKEOLOGJIKE
TË FINIQIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16 e 31 të ligjit nr. 7867, datë 12.10.1994 “Për mbrojtjen e pasurive kulturore, të luajtshme dhe të paluajtshme”, me propozimin e Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpalljen pasuri kulturore monument kulture, me karakter kompleks, dhe vënien në mbrojtje të shtetit të zonës arkeologjike të Finiqit, sipas hartës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve që, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave, Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe institucionet e specializuara të hartojë projektin për ruajtjen dhe restaurimin e elementëve përbërës të kësaj zone.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

